# STATUTI

Ne kete statut
-Ligji eshte Ligji Nr. 9901 dt.14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"
-Statuti eshte statute i shoqerise

## Kreu I

## Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

**Neni 1:**
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 05 Prill 2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me emrin **DETIS SH.P.K**
Themeluesit e shoqërisë janë,

- SAMED HASMEGAJ zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshnme 50,000 leke dhe perben 50% te kapitalit themeltare te shoqerise
- ALSAJET HASMEGAJ zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshnme 50,000 leke dhe perben 50% te kapitalit themeltare te shoqerise
- 

Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar emri ligjor i shoqërisë **DETIS SH.P.K**

**Neni 2:**

**Objekti**
Shoqëria do të kryejnë aktivitetin e mëposhtëm
**("Tregtim me shumice e pakice, eksport import te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore (si dhe ushqim per blegtorine); konfeksione, amballazhe; makineri, pajisje e pjese nderrimi dhe atrecature; bime medicionale; objekte te vjetra-antike, dhe punime te reja shtepiake, punime te ndryshme artistike ne dru, plastike dhe me metale te ndryshme; artikuj kinkalerie; agjenci turistike; pajisje elektro-shtepiake, hidro-sanitare, materiale e lende ndertimi, trasport per vete dhe te trete. Grumbullim dhe tregtim skrapi. Germime dheu. Shitje me shumice dhe me pakice te materialeve te ndryshme te ndertimit. Agjenci logjistike ndermjetese per transport. Transport nderkombetar ajror, tokesor dhe detar, transport nepermjet te treteve, sherbime, agjenci doganore, sherbime aeroportuale, sherbime, shperndarje dhe magazinim, tregti, shitje blerje mjetesh motorrike dhe pjese kembimi, dhenie dhe marrje automjetesh dhe mjetesh transporti me qira, konsulence logjistike si dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur me te qe nuk bien ne ndesh me legjislacionin shqipetar, hoteleri-turizem, eksport-import produktesh ushqimore, distribucim produktesh ushqimore.")**

Alsajet Hasmegaj Samed Hasmegaj

**Neni 3:**
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:**
**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Shkoder Vau Dejes Vau Dejes Rruga Nacionale Mjede-Vau Dejes, godine 2-kateshe, nr pasurie 84/4, zona kadastrale 2702

**Kreu II**
**Kapitali**

**Neni 5:**
**kapitali Themeltare**

(1) Kapitali themeltar aktual i shoqërisë është 100.000 Lekë
(2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm : Ortaku themelues:ù
(3) SAMED HASMEGAJ zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshnme 50,000 leke dhe perben 50% te kapitalit themeltare te shoqerise
(4) ALSAJET HASMEGAJ zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshnme 50,000 leke dhe perben 50% te kapitalit themeltare te shoqerise

**Neni 6:**
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltare per kontributet ne para ,nepermjet kapitalizimit te fitimeve te pa shperndara dhe me ane te kontributeve ne natyre .
Asambleja e ortakeve emeron nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltare te shoqerise.
Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjesesve te kapitalit qe perfaqesojne .

**Neni 7:**
**Tranferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
b) Shitblerjes
c) Trashegimise
d) Dhurimit
e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Pjeset e kapitalit themeltare jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut .
Pjeset e kapitalit themeltare jane lirisht te tranferueshme ne rruge trashegimie.

**Kreu III**
**ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8:**
**Organi Vendimarres**

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise .

ALsajet Hasmegaj

Samed Hasmegaj

Asambleja e ortakeve eshte i vetmi organ vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme :

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
b) ndryshimet e statutit
c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreveemerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te rregjistruar
d) percaktimin e shperblimit per administratoret ,likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar
e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
g) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
j) miratimin e rregullave proceduriale te bledhjeve te asamblese
k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete
Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
Autorizimi nuk mund te jepet per nje mbedhje te asamblese se pergjithshme e cila perfshin edhe mbedhjet vijuese me te njejtin rend dite .

**Neni 9:**
**Menyra e Thirrjes se asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postet elektronike .
Njoftimi me shkrese apo mesazh elektronik duhet te permbaje vendin ,daten oren e mbedhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbedhjen e asamblese.
Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendime pavaresisht parregullsive .

**Neni 10:**
**Kuorumi**
Ne rastin e marrjes se vendimeve ,qe kerkojne nje shumice te zakonshme ,asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave .
Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare " ajo mund te marre vendime te vlefshme nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht ,votojne me shkrese apo me mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenin 88 te ketij ligji .
Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mbidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart asambleja mbidhet perseri jo me vone se 30 dite ,me te njejtin rend dite.

**Neni 11 :**
**Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit ,te ortakeve pjesmarres per ndryshimin e statutit zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar shperndarjen e fitimeve ,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .
Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres ,per ceshtje te tjera si:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te rregjistruar
d) percaktimin e shperblimeve
e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
g) miratimin e rregullave proceduriale te bledhjeve te asamblese

Alsajet Hasmegaj                                                                                    Samed Hasmegaj

Cdo ndryshim statutri duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise .

**Neni 12:**
**Perjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :

a) vleresimin e veprimtarise se tij
b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
c) ngitjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
d) dhenjen ose jo te perfitimeve te reja

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar ,i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflik interesi ashtu si ortaku te cilin perfaqeson .

**Neni 13:**
**Administrimi**

1.Asambleja e Përgjithshme emeron një ose më shume persona fizik si Administratorë të shoqërisë.
Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riperteritje .
Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne qendren kombetare te rregjistrimit .
2.Administratoret e nje shoqerie tregtare meme sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas .Cdo emerim i bere ne kundeshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem .
3.Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbedhja e pare e asamblese se pergjithshme

Të dhënat e identifikimit SAMED HASMEGAJ zoterues i kartes se identitetit me numer 035035799 date leshimi 08,11,2019 .
Nenshkrimi

**Neni 14:**
**Kompetencat e Administratorëve**
Administratoret kane te drejte e detyrohen te :

a) Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise ,duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme .
b) Perfaqesoje shoqerine tregtare
c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
d) Pergadisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilalncin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise .
f) Kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR
g) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare .
h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme ne rastet kur ,

-sipas bilalncit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojnew detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve .

-shoqeria brenda 2 viteve te para te rregjistrimit te saj ,propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise , qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara .

Nese asambleja e pergjithsme emeron me shume se nje administrator ,ato e administrojne bashkarisht shoqerine .

Alsajet Hasmegaj

Samed Hasmegaj

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme .Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te maredhenjeve kontraktore me shoqerine rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Neni 15:**
**Pergjegjesia e Administratorëve**
Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve ,per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise .
Pasojat e mareveshjeve te pa miratuara nga asambleja e pergjithsme qe i sjellim dem shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere mareveshjen per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.
Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithsme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17,18 te ligjit l"Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare "administratori detyrohet :

a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis
b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita
c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ata te shoqerise
e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

2.Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim ,qe lidhet ne nenyre te aresyeshme me qellimet e shoqerise tregtare me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informascioneve perkatese ose mosveprimit eshte kryer ne mirebesim .

3.Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni ,eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te pa rregullta .
Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara .Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare .

4.Ne menyre te vecante por pa u kufizuar ne to administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare kryen veprimet e meposhtme

a) u kthen ortakeve kontributet
b) u paguan ortakeve interesa apo dividente
c) u shperndan aktivet e shoqerise
d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
e) jep kredi

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit .
Paditesi kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiare nese eshte e nevojshme .
Asnje vendimi asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e padise kunder administratoreve per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

**Kreu IV**
**VITI FINANCIARE –EKSPERTET**

**Neni 16:**
**Viti financiare**

Viti financiare i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon 31 Dhjetor .Perjshtimisht viti i pare financiare fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor .
**Neni 17:**

Samed Hasmegaj

Alsajet Hasmegaj

**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise ,ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve .
Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i rregjistruar pergadit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilalncit financiare vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuiar mbi mazen e te drejtes vendimore qe ka .

## Kreu V
## Prishja –Riorganizimi I shoqerise

**Neni 18:**
**prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
b) me vendim te asamblese se ortakeve
c) me hapjen e procedurave te falimentit
d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te rregjistrimit "
e) me vendim te gjykates

Ne kete rast ortaket marrin vendimin me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise duke i caktuar nje ose disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper"
Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likudimit ne gjendjen e aftesise paguese me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi
Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket
Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve brenda 30 diteve pas prishjes ndo person i interesuare mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuiduar .

**Neni 19:**
**Riorganizimi i shoqerise bashkimi –ndarja**

Shoqeria mund te ndahet ,bashkohet sipas vendimit te mbedhjes se pergjithshme te asamblese se ortakeve ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 me ndryshimet "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "

**Neni 20:**
**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.
Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohet dispozitat e ligjit "per tregtaret dhe shoqerite tregtare",kodit civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise .

**Neni 21:**
**Mosmareveshjet**
Per mosmareveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmareveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetence gjykata shqiptare .

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ALSAJET HASMEGAJ SAMED HASMEGAJ